



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
MINISTRI

9186

01.06.2026

UDHËZIM

Nr. 12, Datë 01.06.2026

**“PËR
ZBATIMIN E PROCEDURAVE TË PËRGATITJES SË DEKLARATËS
SË SIGURISË, PROCEDURAVE TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM,
KONTROLLIT TË BRENDSHËM, PROCEDURAVE PËR VERIFIKIMIN
E RASTEVE TË MUNDSHME TË KONFLIKTIT TË INTERESIT, PARREGULLSIVE,
MASHTRIMEVE, KORRUPSIONIT APO AKTIVITETEVE TË TJERA TË
PALIGJSHME, NË KUADËR TË INSTRUMENTIT RGF”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 9 të ligjit nr.19/2025, “Për Ratifikimin e Marrëveshjes së Facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian” dhe të pikave 4 dhe 5, të nenit 13, të VKM nr.252, datë 02.05.2025 “Për përcaktimin e funksioneve të përgjegjësisë e të marrëdhënieve midis autoriteteve dhe strukturave përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin, sipas parashikimeve të marrëveshjes të facilitetit, ratifikuar me ligjin nr.19/2025”;

UDHËZOJ:

I. Të përgjithshme

1. Qëllimi

1.1 Qëllimi i këtij udhëzimi është të përcaktojë rregullat, procedurat dhe metodologjitë për vlerësimin e efektivitetit të funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kryerjen e angazhimit të auditimit të brendshëm, në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF). Ky udhëzim merr në konsideratë kërkesat specifike të marrëveshjes me Bashkimin Evropian dhe përcakton mekanizma shtesë siguridhënieje, me synim garantimin e një niveli të arsyeshëm sigurie mbi:

- a) Ligjshmërinë dhe rregullsinë e përdorimit të fondeve.
- b) Arritjen e objektivave dhe rezultateve të Instrumentit RGF.
- c) Funksionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

1.2 Ky udhëzim përcakton procedurat për:

- a) Përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë bazuar në informacionin dhe sigurinë e marrë nga aktivitetet e kontrollit të brendshëm, verifikimet menaxheriale, raportet e auditimit të brendshëm dhe burime të tjera sigurie.
- b) Përgatitjen e Përmbledhjes së Auditimeve, duke konsoliduar rezultatet e angazhimeve të auditimit të brendshëm dhe aktiviteteve të tjera të siguridhënies që lidhen me zbatimin e instrumentit.
- c) Zbatimin dhe dokumentimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për të garantuar integritetin, transparencën, efektivitetin dhe përdorimin e rregullt të fondeve në kuadër të instrumentit.
- d) Panifikimin dhe kryerjen e angazhimeve të auditimit të brendshëm që lidhen me instrumentin, përfshirë dokumentimin dhe ruajtjen e dosjeve të punës së auditimit dhe evidencave mbështetëse.
- e) Identifikimin, raportimin dhe ndjekjen e rasteve të mundshme të parregullsive, mashtrimit, korrupsionit ose veprimtarive të tjera të paligjshme, përfshirë konfliktet e interesit dhe rastet e mundshme të financimit të dyfishtë, të cilat mund të çenojnë interesat financiare të Bashkimit Evropian.

2. Fusha e Zbatimit

2.1 Marrëdhënia me kuadrin kombëtar rregullator të kontrollit të brendshëm dhe auditimit të brendshëm

- a) Ky udhëzim është në përputhje me kuadrin kombëtar të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik, duke e plotësuar atë me kërkesa specifike për Instrumentin RGF.
- b) Procedurat e përcaktuara nuk zëvendësojnë sistemet ekzistuese institucionale, por vendosin kërkesa shtesë për siguridhënie dhe raportim, të nevojshme për zbatimin dhe raportimin e Instrumentit RGF.
- c) Menaxhimi në institucionet zbatuese mbajnë përgjegjësi të plotë për krijimin, funksionimin dhe monitorimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm
- d) Auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e këtyre sistemeve dhe mbështet kuadrin e përgjithshëm të sigurisë së kërkuar për Instrumentin RGF.

2.2 Kuadri i siguridhënies

- a) Procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim janë pjesë e kuadrit të përgjithshëm të sigurisë për zbatimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF).
- b) Ato sigurojnë që informacioni përkatës nga sistemet e kontrollit të brendshëm, verifikimet menaxheriale, angazhimet e auditimit të brendshëm dhe burime të tjera të siguridhënies, të cilat mblidhen, dokumentohen dhe konsolidohen në mënyrë të përshtatshme për të mbështetur përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë dhe Përmbledhjes së Auditimeve dhe përbëjnë dokumenta mbështetëse kryesore për Kërkesat për Pagesë, sipas Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF).
- c) Këto rregullime kontribuojnë në ofrimin e një sigurie të arsyeshme lidhur me:
 - i. ligjshmërinë dhe rregullsinë e përdorimit të fondeve;
 - ii. arritjen e objektivave, dhe treguesve të performancës, të përcaktuar në kuadër të Instrumentit RGF;

- iii. funksionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm;
- iv. parandalimin, zbulimin dhe raportimin e parregullsive, mashtrimit, korrupsionit, konflikteve të interesit dhe rasteve të financimit të dyfishtë.

2.3 Parimet

- 2.3.1 Të gjitha procedurat e përcaktuara në këtë udhëzim zbatohen në mënyrë objektive dhe të paanshme, duke siguruar transparencë dhe drejtësi procedurale, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet profesionale, si dhe duke respektuar plotësisht të drejtat dhe detyrimet e të gjitha palëve të përfshira.
- 2.3.2 Zbatimi i këtyre procedurave duhet të sigurojë dokumentimin e duhur dhe ruajtjen e evidencave që mbështesin zbatimin e operacioneve, aktivitetet e kontrollit dhe raportimin e sigurtë në kuadër të Instrumentit RGF.

3. Përkufizime

Për qëllimet e këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Kontroll i brendshëm” është procesi i vazhdueshëm i projektuar dhe zbatuar nga menaxhimi dhe stafi i institucionit, i cili synon të ofrojë siguri të arsyeshme për arritjen e objektivave lidhur me ligjshmërinë dhe rregullsinë e operacioneve, mbrojtjen e fondeve, raportimin e besueshëm financiar dhe funksionimin efektiv dhe eficient të veprimtarisë.
- b) “Auditim i brendshëm” është një veprimtari e pavarur dhe objektive sigurimi dhe këshillimi, e projektuar për të shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e institucionit, duke vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes.
- c) “Parregullsi” është çdo shkelje e dispozitave ligjore, kontraktuale ose procedurale të zbatueshme, që rezulton nga një veprim ose mosveprim i një subjekti ekonomik ose institucional dhe që ka ose mund të ketë si pasojë dëmtimin e interesave financiare të Bashkimit Evropian.
- d) “Mashtrim” është çdo veprim ose mosveprim i qëllimshëm, përfshirë paraqitjen e deklaratave ose dokumenteve të rreme apo të pasakta, fshehjen e informacionit ose shpërdorimin e fondeve, me qëllim përfitimin e padrejtë financiar në dëm të interesave financiare të Bashkimit Evropian.
- e) “Financim i dyfishtë” përfshin një situatë kur i njëjti shpenzim, aktivitet ose rezultat financohet më shumë se një herë nga burime të ndryshme publike, përfshirë Instrumentin për Reformë dhe Rritje (RGF), programe të tjera të Bashkimit Evropian, fonde publike kombëtare ose programe të tjera të donatorëve ndërkombëtarë.
- f) “Konflikt i interesit” është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe
- g) Përmbledhja e Auditimeve” është dokumenti që hartohet me rezultatet kryesore të angazhimeve të auditimit të brendshëm dhe aktiviteteve të tjera të sigurimit që lidhen me zbatimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF), duke përfshirë gjetjet kryesore, opinionet dhe rekomandimet përkatëse.
- h) “Deklarata e Sigurisë” është deklarata zyrtare e lëshuar nga autoriteti përgjegjës, e bazuar në një vlerësim të integruar të informacionit të mbledhur nga sistemet e kontrollit të

brendshëm, verifikimet menaxheriale, auditimi i brendshëm dhe burime të tjera të siguridhënies, e cila konfirmon se ekziston një nivel i arsyeshëm sigurie që fondet janë përdorur në përputhje me parimet e ligjshmërisë dhe rregullsisë, janë respektuar parimet e menaxhimit financiar të shëndoshë dhe janë ndërmarrë masa të përshtatshme për parandalimin, identifikimin, raportimin dhe ndjekjen e parregullsive dhe mashtrimeve.

- i) “Kërkesa për Pagesë” është kërkesa zyrtare e paraqitur pranë Komisionit Evropian për disbursimin e fondeve në kuadër të Instrumentin për Reforma dhe Rritje (RGF), e mbështetur nga Deklarata e Sigurisë, Përmbledhja e Auditimeve dhe evidenca të tjera mbështetëse që demonstronjë përmbushjen e kushteve dhe objektivave përkatëse.

4. Kuadri rregullator.

Zbatimi i kontrollit të brendshëm dhe auditimit, në kuadër të këtij instrumenti mbështetet në aktet ligjore dhe rregullatore të mëposhtme:

- a) Rregullore (BE) 2024/1449 e Bashkimit Evropian, që përcakton kornizën e përgjithshme për zbatimin e facilitetit për reforma dhe rritje.
- b) Ligji nr.18/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe BE për mbështetje buxhetore”.
- c) Ligji nr.19/2025, “Për ratifikimin e marrëveshjes së facilitetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian”.
- d) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 02.05.2025, “Për strukturën dhe mekanizmat cionalë për zbatimin e marrëveshjes së facilitetit për reforma dhe rritje”.
- e) Ligji nr.114/2015. “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.
- f) Ligji nr.10296/2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.
- g) Standardet Globale të auditimit të brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.103, datë 23.07.2025. “Për miratimin e Standardeve Globale të auditimit të brendshëm të pranuar për zbatim në sektorin publik në Republikën e Shqipërisë”
- h) Udhëzimi Nr.16, datë 31.12.2024 “Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike”.
- i) Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.4, datë 26.01.2024.
- j) Manuali i Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.134, datë 17.10.2025.

II. Strukturat përgjegjëse dhe përgjegjësitë e tyre në zbatimin e Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Koordinatori Kombëtar (NC)

1.1 Koordinatori Kombëtar është autoriteti përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF) me Komisionin Evropian, përfshirë procesin e zbatimit të reformave dhe investimeve në kuadër të këtij instrumenti.

1.2 Në këtë cilësi, Koordinatori Kombëtar:

- a) Bashkëpunon me ministrinë përgjegjëse për financat për përgatitjen e Deklaratës së Sigurisë.
- b) Nënshkruan Deklaratën e Sigurisë dhe dokumentet e tjera të kërkuara në kuadër të procedurave të raportimit dhe kërkesës për disbursimin e fondeve.
- c) Siguron koordinimin ndër-institucional ndërmjet strukturave përgjegjëse për zbatimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF).

2. Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar

2.1 Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar mbështet Koordinatorin Kombëtar në procesin e koordinimit dhe monitorimit të zbatimit të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (RGF).

2.2 Në këtë kuadër, Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar:

- a) Përgatit raportet gjashtëmujore dhe vjetore mbi progresin e zbatimit të reformave dhe investimeve.
- b) Përgatit kërkesat për pagesë për disbursimin e fondeve.
- c) Ofron asistencë teknike dhe këshillim për ministritë e linjës dhe institucionet zbatuese.
- d) Konsolidon raportet përfundimtare të paraqitura nga institucionet zbatuese.

3. Ministria përgjegjëse për financat

Ministria përgjegjëse për financat, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e kontrollit të brendshëm financiar publik:

- a) Koordinon dhe monitoron funksionimin e sistemit të menaxhimit të parregullive, si dhe zbatimin e masave parandaluese dhe korrigjuese ndaj mashtrimit dhe parregullive.
- b) Forcon dhe ndjek nga afër procedurat e kontrollit të brendshëm dhe mekanizmat e raportimit që lidhen me zbatimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF).
- c) Harton dhe shpërndan udhëzime standarde dhe lista kontrolli për verifikimin dhe dokumentimin e hapave të reformave nga institucionet zbatuese.
- d) Koordinon funksionin e auditimit të brendshëm në institucionet përfituese dhe përgatit Përmbledhjen e Auditimeve, në nivel kombëtar në kuadër të përgatitjes së Deklaratës së Sigurisë.
- e) Përgatit dhe zbaton protokolle bashkëpunimi me institucionet e Bashkimit Evropian, përfshirë Komisionin Evropian, Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF) dhe Zyrën e Prokurorit Publik Evropian, për çështje që lidhen me mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian.
- f) Mbledh dhe vlerëson evidencat e verifikimit dhe dokumentacionin mbështetës nga institucionet zbatuese dhe dërgon brenda datës 5 Korrik dhe 5 Janar të çdo viti, pranë Koordinatorit Kombëtar gjithë dokumentacionin për nënshkrimin e Deklaratës së Sigurisë, e cila bashkëlidhet me kërkesën për disbursimin e fondeve.

4. Ministritë e linjës dhe institucionet zbatuese / përfituese

4.1 Ministritë e linjës dhe institucionet zbatuese/përfituese janë përgjegjëse për planifikimin, zbatimin, monitorimin dhe raportimin e reformave dhe investimeve të mbështetura nga Instrumenti për Reformë dhe Rritje (RGF).

4.2 Detyrimet e ministrive të linjës dhe institucioneve zbatuese / përfituese përfshijnë:

- a) Zbatimin e udhëzimeve të ministrisë përgjegjëse për financat në lidhje me proceset që lidhen me përgatitjen dhe nënshkrimin e Deklaratës së Sigurisë dhe Përmbledhjen e Auditimeve.
- b) Hartimin e planeve tremujore të zbatimit, të përditësuara në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me objektivat dhe treguesit e përcaktuar në Marrëveshjen e Facilitetit.
- c) Sigurimin dhe ruajtjen e evidencave dhe dokumentacionit të verifikueshëm që dokumenton zbatimin real të hapave të reformave.
- d) Sigurimin e funksionimit efektiv të auditimit të brendshëm përmes kryerjes së auditimeve të rregullta të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në përputhje me standardet profesionale dhe kuadrin ligjor kombëtar, si dhe dërgimin e përmbledhjes së auditimeve pranë strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat.
- e) Përgatitjen e raporteve periodike gjashtëmujore dhe vjetore, si dhe çdo raporti tjetër të kërkuar në kuadër të procesit të monitorimit të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF).

5. Nëpunësi Autorizues

Nëpunësi Autorizues siguron që të ndiqet qasja e e standardizuar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke përfshirë hapat thelbësorë për një sistem eficient të kontrollit të brendshëm, si më poshtë:

- a) Ngritjen e një sistemi efektiv të menaxhimit të riskut.
- b) Hartimin e listës së proceseve dhe manualeve të proceseve të punës.
- c) Përgatitjen e gjurmës së auditimit për proceset kryesore të punës.
- d) Analizën e kontroleve ekzistuese dhe atyre të pritshme.
- e) Ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese.
- f) Vlerësimin e pesë komponentëve të kontrollit të brendshëm.
- g) Raportimin përmbledhës mbi funksionimin e kontrollit të brendshëm.

6. Bashkëpunimi me institucionet e Bashkimit Evropian.

6.1 Të gjitha institucionet dhe strukturat e përfshira në zbatimin e fondeve të instrumentit janë të detyruara të bashkëpunojnë plotësisht me:

- a) Komisionin Evropian;
- b) Gjykatën Evropiane të Audituesve;
- c) Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit (OLAF);
- d) Zyrën e Prokurorit Publik Evropian, sipas rastit.

6.2 Bashkëpunimi përfshin sigurimin e aksesit të plotë në:

- a) Dokumentacionin financiar, administrativ dhe teknik.
- b) Sistemet e informacionit.
- c) Personelin përkatës për intervista dhe verifikime.
- d) Vendet e zbatimit të projekteve dhe aktiviteteve.

III. Përgatitja e Deklaratës së Sigurisë

1. Deklarata e Sigurisë, në nivel kombëtar

1.1 Deklarata e Sigurisë është dokumenti kryesor i siguridhënies që mbështet kërkesën për pagesë të paraqitur pranë Komisionit Evropian në kuadër të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF). Deklarata e Sigurisë bazohet në një vlerësim të strukturuar të evidencave, duke përfshirë analizën e riskut, rezultatet e kontroleve dhe auditimeve, dhe nivelin e mbulimit të sigurisë. *Formati standard i Deklaratës së Sigurisë në nivel kombëtar përcaktohet në shtojcën nr.1, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*

1.2 Deklarata e Sigurisë është dokumenti kryesor për fondet e Bashkimit Evropian, përmes të cilit autoriteti përgjegjës garanton:

- a) Plotësinë, saktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar.
- b) Përmbushjen e hapave të reformës dhe investimeve.
- c) Ekzistencën e një gjurme të plotë auditimi për rezultatet e arritura.
- d) Ligjshmërinë dhe rregullsinë e përdorimit të fondeve.
- e) Funkzionimin efektiv të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

1.3 Deklarata e Sigurisë konfirmon se janë zbatuar masa efektive për parandalimin, zbulimin dhe korigjimin e:

- a) Mashtrimit.
- b) Korrupsionit.
- c) Etikës dhe konfliktit të interesit.
- d) Financimit të dyfishtë.

1.4 Deklarata e Sigurisë, në nivel kombëtar përgatitet:

- a) Nga Koordinatori Kombëtar (NC), i mbështetur nga Zyra Mbështetëse e Koordinatorit Kombëtar (NCSO), bazuar në Deklaratat e Sigurisë të lëshuara nga institucionet zbatuese, si dhe Përmbledhjes së Auditimeve (SoA).
- b) Periodikisht, çdo gjashtë muaj ose para çdo kërkesë për pagesë tek Komisioni Evropian.
- c) Duke u shoqëruar me raporte financiare dhe të performancës, për të siguruar që informacioni i deklaruar është i qëndrueshëm, koherent dhe i gjurmueshëm.

2. Deklarata e Sigurisë, në nivel institucional

2.1 Deklarata e Sigurisë në nivel institucional është një vetëvlerësim i përmbushjes së detyrimeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit, i kryer nga Nëpunësi Autorizues në rastin e ministrive, dhe nga i titullari i institucionit në rastin e Ministrave të Shtetit, agjencive të varësisë dhe institucioneve të pavarura, dhe dorëzohet tek ministria përgjegjëse për financat,. *Formati standard i Deklaratës së Sigurisë në nivel institucional përcaktohet në shtojcën nr.2, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*

2.2 Procesi i përgatitjes së Deklaratës së Sigurisë, në nivel institucional

Deklarata e Sigurisë përgatitet sipas hapave të mëposhtëm:

- a) Hartohet nga stafi teknik përgjegjës, i cili mbledh dhe verifikon të dhënat e nevojshme për ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe funksionimin e kontrollit të brendshëm.

- b) Rishikohet nga menaxhimi përgjegjës për kontrollin e brendshëm për të siguruar saktësinë dhe plotësinë e informacionit të përfshirë.
- c) Koordinohet me funksionin e auditimit të brendshëm për të garantuar përputhshmërinë me vlerësimet dhe gjetjet e auditimit.
- d) Mbështetet nga dokumentacioni përkatës dhe gjurma e auditimit, të cilat shërbejnë si evidencë për përgatitjen dhe verifikimin e Deklaratës së Sigurisë.
- e) Nënshkruhet nga Nëpunësi Autorizues ose Drejtori i Përgjithshëm, në cilësinë e autoritetit përgjegjës duhet të garantojë saktësinë dhe integritetin e informacionit të deklaruar.

2.3 Përgatitja e Deklaratës së Sigurisë, në nivel institucional

Deklarata e Sigurisë:

- a) Përgatitet periodikisht, çdo gjashtë muaj ose përpara paraqitjes së çdo kërkesë për pagesë pranë Komisionit Evropian.
- b) Shoqëron raportimin financiar dhe të performancës, duke siguruar që informacioni i deklaruar të jetë i qëndrueshëm, koherent dhe i gjurmueshëm.

2.4 Evidencat mbështetëse të Deklaratës së Sigurisë

Deklarata e Sigurisë mbështetet në evidenca konkrete që përfshijnë:

- a) Sistemet e kontrollit të brendshëm:
 - i. menaxhimin financiar dhe kontrollin;
 - ii. ndarjen e funksioneve ndërmjet strukturave përkatëse;
 - iii. procedurat e dokumentuara dhe manualet e punës.
- b) Kontrollat kryera
 - i. kontrollet administrative;
 - ii. verifikimet në vend;
 - iii. verifikimet financiare.
- c) Përfundimet e auditimeve nga:
 - i. Auditimi i brendshëm;
 - ii. Auditimi i jashtëm;
 - iii. Auditime ose misione të Bashkimit Evropian, sipas rastit.
- d) Menaxhimin e riskut:
 - i. regjistrin e riskut dhe përditësimet e tij;
 - ii. masat për konfliktin e interesit, mashtrimin dhe korrupsionin.

2.5 Struktura standarde e Deklaratës së Sigurisë, në nivel institucional

Deklarata e Sigurisë përmban elementët e mëposhtëm:

- a) Hyrja
 - i. identifikimin e dokumentacionit;
 - ii. institucionin përgjegjës;
 - iii. programin / fondin RGF;
 - iv. periudhën e mbuluar nga deklarata.
- b) Deklarimi formal i sigurisë
 - i. masat janë zbatuar;
 - ii. fondet janë përdorur për qëllimin e tyre të përcaktuar;
 - iii. shpenzimet janë ligjore dhe të rregullta;
 - iv. sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë në mënyrë efektive.

- c) Kufizimet ose rezervat (nëse ka)
 - i. parregullsitë e identifikuara;
 - ii. dobësitë e sistemit të kontrollit të brendshëm;
 - iii. masat korrigjuese të ndërmarra.
- d) Klasifikimi i Deklaratës së Sigurisë
 - i. pa rezerva;
 - ii. me rezerva të kufizuara;
 - iii. me rezerva të rëndësishme.
- e) Angazhimi institucional
 - i. angazhimi për masa korrigjuese;
 - ii. angazhimi për bashkëpunim me institucionet e Bashkimit Evropian.
- f) Të dhënat e nënshkruesit
 - i. emri/mbiemri;
 - ii. funksioni;
 - iii. data;
 - iv. nënshkrimi zyrtar.

IV. Përgatitja e Përmbledhjes së Auditimeve

1. Përmbledhja e Auditimeve, në nivel kombëtar

- 1.1 Ministria përgjegjëse për financat përgatit Përmbledhjen e Auditimeve në nivel kombëtar, duke konsoliduar informacionin e marrë nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucioneve zbatuese të Instrumentit për Reformë dhe Rritje, rregullsinë dhe informacion tjetër të rëndësishëm, të siguruar nga ofruesit e tjerë të siguridhënies. *Formati standard i Përmbledhjes së Auditimeve në nivel kombëtar, përcaktohet në shtojcën nr.3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*
- 1.2 Përmbledhja e Auditimeve, e përgatitur nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm, dorëzohet tek Koordinatori Kombëtar dhe mbështet Deklaratën e Sigurisë, gjatë dorëzimit të Kërkesës për Pagesë tek Komisioni Evropian.

2 Përmbledhja e auditimeve të lidhura me Instrumentin për Reformë dhe Rritje, në nivel institucional

- 2.1 Njësitë e auditimit të brendshëm përgatisin përmbledhjen e auditimeve lidhur me Instrumentin RGF brenda institucioneve zbatuese dhe e dërgojnë zyrtarisht në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat, brenda datës 15 Qershor dhe 15 Dhjetor, të çdo viti kalendarik.
- 2.2 Burimet e informacionit janë:
- a) Raportet e auditimit të brendshëm.
 - b) Auditimet e jashtme.
 - c) Vetëvlerësimet e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
 - d) Kontrollat dhe verifikimet administrative.
 - e) Misionet e auditimit të Bashkimit Evropian, sipas rastit.

2.3 Procesi i konsolidimit:

- a) Mbledhjen dhe analizimin e gjetjeve dhe opinioneve të auditimit.
- b) Vlerësimin e nivelit të riskut dhe dobësive sistematike.
- c) Identifikimin e masave korrigjuese dhe statusit të zbatimit të tyre.
- d) Hartimin e një përmbledhjeje të opinionit të përgjithshëm të siguridhënies.

2.4 Përmbledhja e Auditimeve në nivel institucional dhe në nivel kombëtar kanë strukturë të ngjashme, e cila përfshin:

- a) Informacione të përgjithshme mbi periudhën e auditimit.
- b) Përmbledhje e gjetjeve të raporteve të auditimit të rëndësishme për Instrumentin RGF.
- c) Listë e auditimeve të lidhura me Instrumentin RGF, të kryera gjatë periudhës së raportimit.
- d) Gabime materiale.
- e) Dobësitë e identifikuar në sistemin e kontrollit të brendshëm gjatë auditimit.
- f) Risqet që ndikojnë në interesat financiare të Bashkimit Evropian.
- g) Masat korrigjuese të propozuara për adresimin e gjetjeve dhe dobësive të identifikuar.
- h) Vlerësimi i përgjithshëm i siguridhënies.
 - i. sigurim i arsyeshëm;
 - ii. sigurim i kufizuar;
 - iii. sigurim i pafavorshëm / Pa sigurim.
- i) Nënshkrimi (Emri / Mbiemri / Funkzioni / Data).

2.5 Gjurmueshmëria:

Përmbledhja e Auditimeve duhet të konfirmojë Deklaratën e Sigurisë. Kjo siguron që gjetjet dhe masat korrigjuese të jenë qartësisht në përputhje me Deklaratën e Sigurisë.

- *Formati standard i Përmbledhjes së Auditimeve në nivel institucional, përcaktohet në shtojcën nr.4, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*
- *Formati standard i listës së kontrollit të auditimit të brendshëm për Instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.5, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*
- *Formati standard i listës së kontrollit të auditimit të brendshëm për kontrollin e brendshëm për Instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.6, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*
- *Formati standard i listës së provave të auditimit të brendshëm për Deklaratën e Sigurisë për Instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.7, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.*

V. Procedurat e kontrollit të brendshëm për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Kontrolli i Brendshëm

1.1 Kontrolli i brendshëm, në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Reforma dhe Rritje (RGF), është një proces i vazhdueshëm dhe sistematik, i cili synon të sigurojë:

- a) Përdorimin ligjor, të rregullt, ekonomik, efikas dhe efektiv të fondeve të Bashkimit Evropian për Instrumentin për Reformë dhe Rritje (RGF).
- b) Arritjen e objektivave të Reformës, sipas përcaktimeve në Agjendën Kombëtare të Reformës 2024–2027.

- c) Përmirësimin e menaxhimit të riskut dhe ofrimin e informacionit të besueshëm për Deklaratën e Sigurisë dhe Përmbledhjen e Auditimeve.

1.2 Detyrimet e çdo institucioni përfitues

Çdo institucion përfitues është i detyruar të sigurojë:

- a) Sisteme efektive kontrolli për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e financimit të dyfishtë.
- b) Krijimin e një sistemi transparence për dokumentimin e burimeve të financimit për çdo hap ose aktivitet.
- c) Përgatitjen e një deklaratë sigurie, që konfirmon zbatimin e plotë të kontrolleve dhe raportimin e të gjitha burimeve të financimit.
- d) Vetëdeklarim për përmbushjen e detyrimeve të kontrollit të brendshëm dhe auditimit, i kryer nga Nëpunësi Autorizues për ministritë, dhe nga drejtues institucionesh për agjenci vartësie dhe institucionesh të pavarura, dhe dorëzohet pranë ministrisë përgjegjëse për financat.

1.3 Identifikimi i riskut

- a) Institucionet zbatuese janë të detyruara të identifikojnë riskun për çdo hap të reformës ose investimeve që zbatojnë. Për këtë qëllim, ato përgatisin planet e kontrollit të brendshëm, të cilat përshkruajnë qartë:
 - i. aktivitetet e kontrollit;
 - ii. përgjegjësitë;
 - iii. afatet;
 - iv. metodat e monitorimit.
- b) Planet e kontrollit të brendshëm duhet të përfshijnë:
 - i. fushat me risk të lartë të mospërputhshmërisë ose parregullsisë;
 - ii. masat parandaluese dhe korrigjuese për çdo risk të identifikuar;
 - iii. përgjegjësitë për zbatimin e kontrolleve dhe afatet përkatëse;
 - iv. metodologjitë e monitorimit dhe vlerësimit të masave.

1.4 Zbatimi i kontrolleve të brendshme

- a) Zbatimi i kontrolleve të brendshme përfshin verifikime administrative dhe financiare, të cilat mund të përfshijnë analiza dokumentesh ose kontrolle në vend.
- b) Këto veprime kryhen për të verifikuar se:
 - i. masat janë zbatuar sipas planit;
 - ii. fondet janë përdorur në mënyrë të ligjshme dhe të duhur.
 - iii. çdo rezultat i kontrollit dokumentohet në formate të standardizuara dhe të miratuara, për:
 - iii.1. kontrollin e ligjshmërisë, rregullsisë dhe efektivitetit të shpenzimeve;
 - iii.2. vlerësimin e përputhshmërisë së reformave me hapat dhe treguesit e miratuar.

1.5 Funkcionet e Nëpunësit Autorizues për sistemin e kontrollit të brendshëm të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF)

- a) Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është koordinatori i menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe kryetar i grupit të menaxhimit të riskut të njësisë publike.
- b) Përgjegjësia kryesore për zbatimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit i përket Nëpunësit Autorizues, në cilësinë e koordinatorit të MFK të njësisë

publike. Menaxherët në të gjitha nivelet e njësisë publike dhe të gjithë punonjësit duhet të jenë të përfshirë gjerësisht në këtë proces për:

- i. zbatimin e sistemit të MFK, duke siguruar funksionimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm;
 - ii. identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin e riskut që ndikon në arritjen e objektivave të strukturave nën përgjegjësinë e tyre, në përputhje me procesin e menaxhimit të riskut dhe metodologjinë e miratuar nga njësia publike;
 - iii. menaxhimin dhe raportimin e riskut të njësisë publike, në përputhje me nivelin e ndikimit të aktiviteteve të strukturave që ata udhëheqin, si dhe brenda kufijve dhe afateve të përcaktuara në planet e miratuara të menaxhimit dhe trajtimit të riskut të njësisë publike.
- c) Zbatimi dhe funksionimi efektiv i MFK
- i. Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të MFK në të gjitha njësitë, strukturat, programet, aktivitetet dhe proceset nën autoritetin e tij/saj, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndetshëm financiar dhe transparencës;
 - ii. Nëpunësi Autorizues siguron krijimin, vlerësimin dhe përmirësimin e sistemit të MFK, duke përfshirë:
 - ii.1. krijimin dhe monitorimin e menaxhimit të riskut;
 - ii.2. dokumentimin e proceseve dhe gjurmëve të auditimit;
 - ii.3. analizën dhe forcimin e kontroleve;
 - ii.4. zbatimin e masave korigjuese për dobësitë e identifikuara;
 - ii.5. vlerësimin e pesë komponentëve të kontrollit të brendshëm;
 - ii.6. raportimin përmbledhës mbi efektivitetin e përgjithshëm të sistemit të MFK.

Formati standard i pyetësorit për kontrollin e brendshëm për Instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.8, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Vlerësimi i riskut për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

2.1 Menaxhimi i Riskut është procesi i identifikimit, analizës, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, si dhe marrja e veprimeve të nevojshme për eliminimin e faktorëve që pengojnë realizimin e objektivave të njësisë publike, duke arritur:

- a) Marrjen e vendimeve më të mira, nëpërmjet vlerësimit të rezultateve të pritshme dhe risqeve që mund të çojnë në rezultate të paplanifikuara
- b) Garanci të arsyeshme se objektivat e planifikuara do të arrihen.
- c) Planifikim dhe menaxhim më të mirë të burimeve në dispozicion.
- d) Adresimin e përparësive.
- e) Besimin e fortë të sistemi i menaxhimit.
- f) Zhvillimin e një kulture institucionale pozitive.

2.2 Për të siguruar një zbatim të suksesshëm të menaxhimit të riskut në njësinë publike duhet të plotësohen parakushtet e mëposhtme:

- a) Mjedisi i kontrollit që mbështet realizimin e procesit të menaxhimit të riskut.
- b) Rrjeti i komunikimit të risqeve dhe aktiviteteve që ndërmerren për këtë qëllim.
- c) Mbështetje e fortë nga niveli i lartë i menaxhimit.

2.3 Menaxhimi i riskut mundëson:

- a) Parashikimin e risqeve dhe ngjarjeve, që mund të pengojnë realizimin e objektivave.
- b) Fokusimin te kontrollet e brendshme dhe burimet e kufizuara në fusha të rëndësishme të aktiviteteve dhe risqeve, që lidhen me to.

2.4 Qëllimi i vlerësimit të riskut është të:

- a) Identifikojë risqet që mund të pengojnë arritjen e objektivave të Instrumentit RGF.
- b) Vlerësojë ndikimin e tyre në interesat financiare të BE.
- c) Përcaktojë masat e kontrollit dhe prioritetet e trajtimit.
- d) Shërbejë si bazë për menaxhimin e riskut, planifikimin e auditimit të brendshëm dhe Deklaratës së Sigurisë.

2.5 Vlerësimi i riskut kryhet në përputhje me:

- a) Menaxhimin e shëndoshë financiar (ekonomicitet, efikasitet, efektivitet).
- b) Qasjen e bazuar në risk.
- c) Proporcionalitetin e kontrolleve.
- d) Tolerancën zero ndaj mashtrimit dhe korrupsionit.
- e) Dokumentimin dhe gjurmueshmërinë.

2.6 Kategoritë kryesore të riskut për instrumentin RGF janë:

- a) Risku strategjik
 - i. mosrealizimi ose realizimi i pjesshëm i objektivave strategjike të Instrumentit RGF;
 - ii. përdorimi joefektiv ose i pamjaftueshëm i instrumentit të garancisë financiare;
 - iii. ndikim i kufizuar ose i pamjaftueshëm në mbështetjen dhe zhvillimin e fushave prioritare.
- b) Risku financiar
 - i. shpenzime të papranueshme;
 - ii. humbje financiare nga aktivizimi i garancive;
 - iii. raportim financiar i pasaktë;
 - iv. financimi i dyfishtë.
- c) Risku i përputhshmërisë
 - i. shkelje e rregullave të BE / RGF;
 - ii. moszbatim i marrëveshjeve për Instrumentin RGF;
 - iii. korrigjime financiare nga BE.
- d) Risku operacional
 - i. procese joefektive;
 - ii. kapacitete të pamjaftueshme;
 - iii. mungesë koordinimi me ndërmjetësit financiarë.
- e) Risku i mashtrimit dhe korrupsionit
 - i. konflikti i interesit;
 - ii. deklaram i rremë nga përfituesit finalë;
 - iii. dobësi në kontrollet anti-mashtrim.
- f) Risku reputacional
 - i. humbje besimi nga BE.
 - ii. dëmtim i besueshmërisë institucionale.

2.7 Procesi i vlerësimit të riskut

- a) Risqet identifikohen për çdo:
 - i. objektiv strategjik për Instrumentin RGF;
 - ii. proces kyç (menaxhim, financë, raportim);
 - iii. ndërmjetës financiar dhe përfitues final.
- b) Burimet për vlerësimin e riskut janë:
 - i. auditime të mëparshme;
 - ii. raporte të BE;
 - iii. analiza të proceseve;
 - iv. sinjalizime dhe parregullsi.

2.8 Analiza dhe vlerësimi i riskut

- a) Çdo risk vlerësohet sipas:
 - a.1. probabilitetit:
 - i. i ulët (1);
 - ii. i mesëm (2);
 - iii. i lartë (3).
 - a.2. ndikimit:
 - i. i ulët (1);
 - ii. i mesëm (2);
 - iii. i lartë (3).
- b) Niveli i riskut = Probabilitet × Ndikim

2.9 Risku klasifikohet:

- a) Rezultati Niveli i riskut Trajtimi
1–2 I ulët Monitorim
3–4 I mesëm Masa kontrolli
6–9 I lartë Veprim i menjëhershëm
- b) Risqet që lidhen me mashtrim, korrupsion dhe interesa financiare të BE, trajtohen gjithmonë si risk i lartë.

2.10 Trajtimi i riskut

- a) Për çdo risk përcaktohet:
 - i. masa parandaluese dhe zbuluese;
 - ii. pronari i riskut;
 - iii. afati i zbatimit;
 - iv. risku i mbetur.
- b) Strategjitë në trajtimin e riskut janë:
 - i. shmangie;
 - ii. reduktim;
 - iii. transferim;
 - iv. pranim (vetëm për riskun e ulët).

2.11 Regjistri i riskut për Instrumentin RGF, përfshin:

- a) Përshkrimin e riskut.
- b) Kategorinë.
- c) Nivelin fillestar.
- d) Kontrollat ekzistuese.
- e) Masat shpesh.
- f) Riskun e mbetur.

Formati standard i regjistrit të riskut për Instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.9, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2.12 Rishikimi dhe përditësimi i riskut

- a) Kryhet të paktën një herë në vit.
- b) Përditësohet në rast ndryshimesh të rëndësishme.
- c) Rishikohet pas gjetjeve të auditimit ose rasteve të parregullive.

2.13 Përdorimi i rezultateteve të vlerësimit të riskut

- a) Hartimi i planit të auditimit të brendshëm.
- b) Forcimi i sistemit të kontrollit të brendshëm,
- c) Përgatitja e Deklaratës së Sigurisë.

2.14 Çdo institucion mban dhe përditëson regjistrin e riskut për fondet RGF të Bashkimit Evropian, i cili identifikon dhe vlerëson risqet kryesore financiare, operacionale, të përputhshmërisë dhe të integritetit, që lidhen me zbatimin e instrumentit të garancisë, në përputhje me rregullat e BE-së.

3. Parandalimi dhe kontrolli i financimit të dyfishtë për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

3.1 Financimi i dyfishtë mund të ndodhë jo vetëm në nivelin e kostove, por edhe kur të njëjtat rezultate ose produkte raportohen nën instrumente të ndryshme financimi, gjë që nuk është në përputhje me parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

3.2 Institucionet zbatuese duhet të vendosin mekanizma të përshtatshëm të kontrollit të brendshëm për të parandaluar, zbuluar dhe adresuar rastet e financimit të dyfishtë në lidhje me zbatimin e Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF). Këto mekanizma duhet të sigurojnë që fondet e dhëna nën Instrument të jenë plotësuese me burime të tjera financimi dhe të mos financojnë të njëjtën kosto ose aktivitet dy herë, në përputhje me rregullat përkatëse të BE.

3.3 Risqet kryesore të financimit të dyfishtë lidhen me:

- a) Mungesën e koordinimit midis programeve.
- b) Sisteme të papërshtatshme të ndjekjes së projekteve.
- c) Deklarata të pasakta nga përfituesit.

3.4 Sistemi i kontrollit të brendshëm për parandalimin e financimit të dyfishtë duhet të përfshijë, të paktën, elementet e mëposhtme:

- a) Identifikimi i burimeve të financimit

Institucionet zbatuese duhet të mbajnë regjistra të plotë dhe të përditësuar të të gjitha burimeve të financimit, të lidhura me zbatimin e masave të reformës ose investimeve nën Instrument.

- b) Procedurat e verifikimit
Para raportimit të shpenzimeve, ose rezultateve të lidhura me Instrumentin, institucionet duhet të verifikojnë nëse i njëjti aktivitet ose rezultat ka marrë financim nga programe të tjera të BE, fonde kombëtare ose donatorë ndërkombëtarë.
- c) Gjurmueshmëria financiare
Sistemet kontabël dhe raportuese duhet të lejojnë identifikimin e qartë të burimit të financimit për çdo aktivitet, kontratë ose artikull shpenzimi.
- d) Deklaratat e përfituesve
Kur është e nevojshme, përfituesit duhet të japin deklaratat të shkruara që konfirmojnë se aktivitetet e financuara nuk kanë marrë financim të mbivendosur nga burime të tjera.
- e) Koordinimi midis programeve
Institucionet e përfshira në zbatimin e Instrumentit duhet të bashkëpunojnë me autoritetet kombëtare të koordinimit dhe strukturat e tjera të menaxhimit të programeve për të siguruar shkëmbim të plotë të informacionit mbi burimet e financimit.
- f) Dokumentimi dhe gjurma e auditimit.
Të gjitha aktivitetet e kontrollit lidhur me parandalimin e financimit të dyfishtë, duhet të dokumentohen, siç duhet dhe të ruhen si pjesë e gjurmës së auditimit.

VI. Parimet dhe procedurat e auditimit të brendshëm për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Auditimi i Brendshëm

1.1 Funkzioni i auditimit të brendshëm, në kuadër të zbatimit të Instrumentit për Reformë dhe Rritje (RGF), ushtrohet në përputhje me parimet e përcaktuara në Standardeve Globale të auditimit të brendshëm, të pranuar sa më poshtë:

- a) “Demonstrimi i Integritetit” - Audituesit e brendshëm veprojnë me ndershmëri dhe guxim profesional, duke respektuar parimet morale dhe etike.
- b) “Ruajtja e Objektivitetit” - Audituesit e brendshëm mbajnë një qëndrim të paanshëm dhe të drejtë gjatë kryerjes së shërbimeve.
- c) “Demonstrimi i Kompetencës” - Audituesit e brendshëm zotërojnë njohuritë, aftësitë dhe teknikat e nevojshme për të përmbushur detyrat e tyre.
- d) “Ushtrimi i Kujdesit të Duhur Profesional” - Audituesit e brendshëm planifikojnë dhe kryejnë punën me kujdesin e duhur profesional dhe skepticizëm.
- e) “Ruajtja e Konfidencialitetit” - Audituesit e brendshëm mbrojnë dhe përdorin informacionin në mënyrë të përshtatshme.
- f) “Autorizimi nga Bordi/Titullari” – Bordi/Titullari miraton mandatin e funksionit të auditimit të brendshëm dhe mbështet autoritetin e tij.
- g) “Pozicionimi i Pavarur” - Funkzioni i auditimit të brendshëm duhet të jetë i pavarur dhe i pozicionuar në mënyrë që të kryejë detyrat pa ndërhyrje.
- h) “Mbikëqyrja nga Bordi/Titullari” – Bordi/Titullari mbikëqyr funksionin e auditimit të brendshëm për të siguruar efektivitetin e tij.

- i) “Planifikimi Strategjik” - Drejtuesi i auditimit të brendshëm planifikon në mënyrë strategjike për të përmbushur mandatin dhe objektivat afatgjata.
- j) “Menaxhimi i Burimeve” - Funkzioni i auditimit të brendshëm menaxhon burimet financiare, njerëzore dhe teknologjike në mënyrë efektive.
- k) “Komunikimi Efektiv” - Audituesit e brendshëm komunikojnë qartë dhe në kohë me palët e interesit për rezultatet dhe risqet.
- l) “Rritja e Cilësisë” - Funkzioni i auditimit të brendshëm zbaton programe për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.
- m) “Planifikimi i Angazhimeve” - Audituesit e brendshëm planifikojnë angazhimet duke marrë parasysh risqet dhe objektivat e organizatës.
- n) “Kryerja e Punës së Angazhimit” - Audituesit e brendshëm mbledhin, analizojnë dhe vlerësojnë informacionin për të arritur objektivat e angazhimit.
- o) “Komunikimi i Rezultateve dhe Monitorimi” - Audituesit e brendshëm komunikojnë rezultatet e angazhimit dhe monitorojnë zbatimin e rekomandimeve.

1.2 Planifikimi i auditimit të brendshëm për fondet RGF

- a) Auditimi planifikohet brenda planeve strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm sipas procedurave standarde të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrisë të Financave nr.134, datë 17.10.2025 “Për miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.
- b) Auditimi identifikon dhe dokumenton universin e auditimit, duke mbuluar të gjitha proceset dhe funksionet lidhur me menaxhimin dhe zbatimin e Instrumentit RGF:
 - i. strukturat e qeverisjes, menaxhimit dhe zbatimit;
 - ii. përzgjedhja dhe monitorimi i operacioneve;
 - iii. menaxhimi financiar dhe kontabiliteti;
 - iv. sistemet e kontrollit të brendshëm;
 - v. procedurat për trajtimin e parregullsive, mashtrimin dhe konfliktin e interesit;
 - vi. raportimi tek autoritetet kombëtare dhe institucioneve të BE.
- c) Planifikimi bazohet në vlerësimin e dokumentuar dhe të përditësuar të riskut, duke përfshirë:
 - i. riskun financiar;
 - ii. riskun për mashtrim dhe korrupsion;
 - iii. riskun e konfliktit të interesit;
 - iv. kompleksitetin e instrumenteve financiare;
 - v. vlerën e fondeve dhe rëndësinë strategjike;
 - vi. gjetjet e auditimeve të mëparshme dhe statusin e zbatimit të rekomandimeve;
 - vii. ndryshimet institucionale ose procedurale.
- d) Planifikimi merr në konsideratë:
 - i. kërkesat dhe prioritetet e Komisionit Evropian;
 - ii. gjetjet dhe rekomandimet nga auditimet e jashtme;
 - iii. parandalimin e auditimeve të dyfishta;
 - iv. nevojën për raportim të besueshëm për Deklaratën e Sigurisë.
- e) Objektivat strategjike për fondet RGF integrohen në sistemin e menaxhimit të riskut dhe mbështeten nga një plan auditimi i bazuar në risk, për të vlerësuar vazhdimisht efektivitetin e kontroleve dhe për të mbrojtur interesat financiare të BE.

- f) Mbulimi i të gjitha proceseve me risk të lartë të fondeve RGF nga auditimi i brendshëm, të paktën një herë në çdo 12 muaj.

1.3 Elementet e vlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm:

- a) Mjedisi i Kontrollit
- i. struktura organizative dhe përgjegjësitë e çdo punonjësi;
 - ii. politikat e integritetit dhe etikës;
 - iii. kompetencat dhe trajnimi i stafit për zbatimin efektiv të kontrollit të brendshëm;
 - iv. pavarësia dhe funksionimi i auditimit të brendshëm në vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.
- b) Vlerësimi i Riskut
- i. identifikimi dhe dokumentimi i riskut për fondet RGF;
 - ii. risqet financiare, operacionale dhe të përputhshmërisë;
 - iii. risqet e mashtrimit dhe konfliktit të interesit;
 - iv. masat e vendosura për menaxhimin e çdo risku të identifikuar.
- c) Aktivitetet e Kontrollit
- i. autorizimet dhe miratimet;
 - ii. ndarja e detyrave;
 - iii. kontrole parandaluese dhe korigjuese;
 - iv. verifikime financiare dhe operacionale;
 - v. kontrole të sigurisë IT-së dhe të të dhënave.
- d) Informacioni dhe Komunikimi
- i. saktësia dhe besueshmëria e raportimit financiar;
 - ii. komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm;
 - iii. raportimi i parregullsive dhe mekanizmi i sinjalizuesve;
 - iv. rrjedha e informacionit tek BE dhe autoritetet përkatëse.
- e) Monitorimi
- i. monitorimi i vazhdueshëm i kontrollit të brendshëm;
 - ii. ndjekja e gjetjeve dhe rekomandimeve pas vlerësimit të kontrollit të brendshëm;
 - iii. auditimet e brendshme dhe të jashtme;
 - iv. veprimet korigjuese dhe përmirësuese.

2. Auditimi i financimit të dyfishtë për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

2.1 Auditimi i brendshëm i kushton vëmendje të veçantë:

- a) Ekzistencës dhe efektivitetit të mekanizmave parandaluese.
- b) Deklarimeve të sakta mbi mungesën e financimit të dyfishtë.
- c) Shpenzimeve unike, të justifikuara dhe të gjurmueshme.
- d) Kryerjes së kontroleve të kryqëzuara midis burimeve të financimit.

2.2 Njësitë e auditimit të brendshëm vlerësojnë nëse brenda institucionit ekzistojnë mekanizma të pershtatshëm dhe efektivë për të parandaluar, zbuluar dhe korigjuar rastet e financimit të dyfishtë lidhur me zbatimin e Instrumentit RGF. Gjatë auditimeve, audituesit vlerësojnë nëse:

- a) Procedurat e kontrollit të brendshëm sigurojnë që i njëjti shpenzim ose aktivitet të mos financohet nga disa burime.

- b) Institucionet zbatuese mbajnë informacion të besueshëm për të gjitha burimet e financimit lidhur me masat dhe investimet e reformës.
- c) Deklaratat për mungesën e financimit të dyfishtë mblidhen dhe verifikohen.
- d) Sistemet kontabël dhe raportuese mundësojnë gjurmueshmërinë e burimeve të financimit.
- e) Kryhen kontrole të kryqëzuara midis programeve të financimit kur është e nevojshme.

2.3 Procedurat e auditimit për vlerësimin e riskut të financimit të dyfishtë përfshijnë:

- a) Rishikim të dokumentacionit financiar dhe kontratave.
- b) Krahasim të listave të projekteve të financuara nga programe të ndryshme.
- c) Analizë të regjistrave kontabël dhe klasifikimeve buxhetore.
- d) Verifikim të deklaratave të përfituesve.
- e) Përdorim të bazave të të dhënave kombëtare ose ndërkombëtare për financimet e BE.
- f) Intervista me zyrtarët përgjegjës dhe verifikime në vend, sipas nevojës.

Formati standard i listës së kontrollit të auditimit të brendshëm për financimin e dyfishtë për instrumentin RGF, përcaktohet në shtojcën nr.10, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

3. Objektivi SMART të auditimit të brendshëm për fondet RGF

3.1 Sigurimi i mbulimit me auditim të brendshëm të të gjitha proceseve me risk të lartë që lidhen me fondet RGF, të paktën një herë në çdo periudhë 12-mujore.

3.2 Treguesit kryesorë të performancës (KPI) përfshijnë:

- a) Përqindjen (%) e proceseve me risk të lartë të audituara kundrejt totalit.
- b) Numrin e angazhimeve të auditimit të realizuara sipas planit vjetor.
- c) Nivelin e devijimit nga plani vjetor i auditimit (në %).

4. Angazhimi i auditimit të brendshëm për fondet RGF

4.1 Auditimi i fondeve kryhet sipas procedurave standard të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.134, datë 17.10.2025 “Për miratimin e Manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

4.2 Audituesit e brendshëm për fondet RGF ndër të tjera, vlerësojnë nëse:

- a) Ekzistojnë dhe funksionojnë mekanizma efektivë parandalues.
- b) Janë bërë deklaratat të sakta dhe të verifikuara për mungesë financimi të dyfishtë.
- c) Shpenzimet janë unike, të justifikuara dhe të gjurmueshme.
- d) Kryhen kontrole të kryqëzuara ndërmjet burimeve të financimit dhe programeve përkatëse.

4.3 Raporti i parregullsive për fondet RGF

- a) Raportimi i parregullsive siguron që çdo mospërputhje, shkelje ose risk i identifikuar të komunikohet në mënyrë të qartë dhe të dokumentuar.
- b) Hapat për raportimin e parregullsive
 - i. identifikimi i parregullsisë;

- ii. administrimi i provave gjatë auditimit;
- iii. evidenca të qarta.
- c) Përmbajtja e çdo parregullsie
 - i. përshkrimi i parregullsisë;
 - ii. kriteri i shkelur;
 - iii. evidencat që e mbështesin;
 - iv. risku/ndikimi;
 - v. rekomandimi për korrigjim.
- d) Komunikimi
 - i. diskutohet me njësinë e audituar;
 - ii. përfshihet në raportin përfundimtar të auditimit;
 - iii. në rast parregullsish kritike, njoftohet menjëherë menaxhimi i lartë.
- e) Raporti i parregullsive
 - i. është pjesë e raportit të auditimit të brendshëm;
 - ii. duhet të jetë i qartë, i paanshëm dhe i strukturuar.

5. Auditimet Horizontale për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

- 5.1 Në kuadër të Instrumentit RGF, një numër reformash dhe hapash reforme zbatohen përmes veprimeve të koordinuara të disa institucioneve publike ose mbështeten në sisteme dhe procese administrative që funksionojnë në të gjithë sektorin publik.
- 5.2 Në këto raste, aktivitetet e auditimit të brendshëm mund të organizohen si auditime horizontale, duke mbuluar një fushë reforme, një objektiv politik ose një proces operativ që zbatohet në disa institucione.
- 5.3 Qëllimi i auditimeve horizontale është të sigurojë vlerësim mbi:
- a) Strukturat e qeverisjes dhe mekanizmat e koordinimit ndërinstitucional.
 - b) Praktikën e menaxhimit të riskut.
 - c) Sistemet e kontrollit të brendshëm lidhur me zbatimin e reformave dhe investimeve të mbështetura nga Instrumenti RGF.
- 5.4 Auditimet horizontale u mundësojnë audituesve të brendshëm të identifikojnë dobësi sistemike dhe risqe të përbashkëta që mund të ndikojnë në zbatimin e duhur të Instrumentit RGF dhe në mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian.
- 5.5 Auditimet horizontale mund të kryhen kur:
- a) Hapat e reformës përfshijnë më shumë se një institucion zbatues.
 - b) Zbatimi i reformave mbështetet në sisteme ose procedura administrative të përbashkëta.
 - c) Mekanizmat e koordinimit ndërmjet institucioneve janë thelbësore për arritjen e objektivave të reformës.
 - d) Risqet ose dobësitë e kontrollit mund të ndikojnë në disa institucione njëkohësisht.
- 5.6 Në varësi të natyrës së reformës, auditimet horizontale mund të përfshijnë fusha të tilla si:
- a) Shërbimet digjitale publike dhe sistemet e informacionit që përdoren në të gjithë qeverinë.

- b) Sistemet për parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit, korrupsionit dhe konflikteve të interesit që prekin fondet e BE.
- c) Reforma ndërsektoriale lidhur me zhvillimin e tregut të punës dhe sistemet arsimore.
- d) Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe shërbimeve publike administrative.
- e) Fusha të tjera reformash, të identifikuarat përmes vlerësimit të riskut ose planifikimit të auditimit.

5.7 Auditimet horizontale mund të vlerësojnë, ndër të tjera:

- a) Efektivitetin e koordinimit dhe të strukturave të qeverisjes.
- b) Funksonimin dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.
- c) Besueshmërinë, plotësinë dhe gjurmueshmërinë e mekanizmave të raportimit dhe dokumentacionit mbështetës.
- d) Qëndrueshmërinë dhe uniformitetin e zbatimit të reformës në të gjitha institucionet.

5.8 Auditimet horizontale duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të auditimit të brendshëm bazuar në risk, veçanërisht kur hapat e reformës përfshijnë disa institucione ose janë identifikuar risqe sistemike.

5.9 Kur zbatimi i një hapi reforme përfshin disa institucione, njësitë e auditimit të brendshëm mund të koordinojnë aktivitetet e tyre për të siguruar mbulim të mjaftueshëm të auditimit dhe për të shmangur punën e dyfishtë. Auditimet horizontale mund të kryhen përmes angazhimeve të koordinuara të auditimit, ku njësitë e auditimit të institucioneve përkatëse shqyrtojnë procese ose hapa reforme të ngjashme brenda institucioneve të tyre, duke ndarë informacion dhe metodologji të auditimit.

5.10 Gjatë organizimit të auditimeve horizontale, duhet të merret në konsideratë:

- a) Pavarësia funksionale dhe mandati i njërive të auditimit të brendshëm brenda institucioneve të tyre.
- b) Mbrojtja e informacionit konfidencial dhe të ndjeshëm të marrë gjatë auditimeve.
- c) Rregullat e aksesit në dokumentacion dhe informacion në institucionet publike.
- d) Nevoja për të siguruar që evidencat dhe dokumentet e punës të dokumentohen dhe të ruhen sipas rregullave të përcaktuara.

5.11 Veçanërisht, gjetjet e këtyre auditimeve mbështesin:

- a) Identifikimin e dobësive sistemike që prekin disa institucione.
- b) Përmirësimin e mekanizmave të koordinimit për zbatimin e reformave.
- c) Forcimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut.
- d) Përgatitjen e Përmbledhjes së Auditimeve dhe Deklaratës së Sigurisë.

VII. Procedura e trajtimit të parregullsive për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Trajtimi i parregullsive

- 1.1 Të gjitha institucionet, strukturat, njësitë zbatuese dhe subjektet e përfshira në menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e fondeve në kuadër të Instrumentit RGF, caktojnë zyrtarisht një nëpunës për parregullsitë.
- 1.2 Të gjitha parregullsitë serioze ose mashtrimet e dyshuara për fondet RGF, raportohen pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik/AFCOS.
- 1.3 Roli i nëpunësit të parregullsive në institucionin përfitues
 - a) Identifikimi dhe dokumentimi i parregullsive.
 - b) Mbledhja e informacionit dhe provave fillestare për parregullsitë dhe mashtrimet e dyshuara.
 - c) Sigurimi i raportimit të brendshëm në institucion.
 - d) Njoftimi i AFCOS për çdo parregullsi serioze apo dyshim për mashtrim.
 - e) Ndjekja dhe raportimi i masave korrigjuese në nivel institucioni.
 - f) Bashkëpunimi me auditimin e brendshëm dhe strukturat e kontrollit të brendshëm.
- 1.4 Nëpunësi i parregullsive në institucionin përfitues caktohet me urdhër të Nëpunësit Autorizues, ku përcaktohen:
 - a) Detyrat.
 - b) Përgjegjësitë.
 - c) Forma e komunikimit me AFCOS.
- 1.5 Nëpunësi i parregullsive duhet:
 - a) Të jetë i pavarur nga funksionet e zbatimit financiar dhe operacional.
 - b) Të ketë njohuri për menaxhimin e fondeve të BE dhe kontrollin financiar.
 - c) Të mos jetë i përfshirë drejtpërdrejtë në zbatimin e projekteve.
 - d) Të ketë integritet profesional dhe eksperiencë institucionale.
- 1.6 Për të garantuar integritetin dhe transparencën në zbatimin e reformave, institucionet zbatuese duhet të vendosin mekanizma funksionalë për parandalimin e mashtrimit, korrupsionit dhe parregullsive serioze, duke përfshirë:
 - a) Protokolle të brendshme për sinjalizimin e shkeljeve.
 - b) Mbrojtjen e sinjalizuesve në përputhje me standardet e BE dhe legjislacionin kombëtar në fuqi.
 - c) Trajnime të rregullta për stafin mbi etikën, integritetin, konfliktin e interesit dhe detyrimet ligjore që lidhen me administrimin dhe zbatimin e fondeve publike dhe të BE.
- 1.7 Institucionet kanë detyrimin të ruajnë një kulturë të kontrollit të brendshëm, duke përfshirë gjithë stafin në identifikimin, parandalimin dhe raportimin e çdo devijimi nga rregullat dhe objektivat e Instrumentit RGF.

2. Raportimi i parregullsive

2.1 Procedura e raportimit nëpërmjet sistemit IMS:

- a) Institucioni përfitues raporton çdo parregullsi ose dyshim për mashtrim vetëm përmes portalit AFIS/sistemit IMS (Sistemi i Menaxhimit të Parregullsive), ose sistem tjetër raportimi të BE.
 - b) Raportimi bëhet:
 - i. menjëherë pas identifikimit të rastit,
 - ii. pavarësisht vlerës financiare ose fazës së zbatimit;
 - iii. në përputhje me kërkesat për plotësinë dhe saktësinë e të dhënave.
- 2.2 Roli i nëpunësve të parregullsive është të krijojnë dhe mirëmbajnë dosjet e parregullsive në lidhje me sinjalizimin e parregullsive dhe regjistrin e sinjalizimeve të parregullsive. Gjithashtu, nëpunësit e parregullsive përgatisin raporte mbi vlerësimin e parregullsive ose sinjalizimeve të parregullsive, hartojnë vendime mbi parregullsitë, regjistrojnë dhe ndjekin parregullsitë e konstatuara në portalit AFIS/sistemit IMS deri në përfundimin e tyre, duke regjistruar progresin e bërë nëpërmjet veprimeve përkatëse pasuese.
- 2.3 Nëpunësit e parregullsive sigurojnë ndërlidhjen dhe rrjedhën efektive të komunikimit brenda institucionit, si dhe midis institucionit dhe subjekteve të jashtme (strukturat e tjera të IPA, AFCOS, shërbimet e prokurorisë, gjykatat, audituesit e Komisionit Evropian, etj.).
- 2.4 I gjithë stafi i institucionit ka detyrimin që të jetë i vetëdijshëm për detyrat e tij, në lidhje me zbulimin, regjistrimin dhe raportimin e parregullsive, si dhe të drejtën e tij për t'u mbrojtur për sinjalizimet e kryera gjatë raportimit të parregullsive.
- 2.5 Të gjitha rastet e parregullsive të konstatuara dhe të regjistruara raportohen nga ZKA, nëpërmjet Zyrës së Mbështetjes së ZKA-së, pranë Komisionit Evropian, pa vonesë dhe në përputhje me kërkesat e përcaktuara të raportimit të Bashkimit Evropian
- 2.6 Rastet e parregullsive serioze ose të mashtrimit të dyshuar adresohen pranë Zyrës së Mbështetjes së ZKA-së, regjistrohen njëkohësisht në Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive (portalit AFIS/sistemit IMS) dhe raportohen menjëherë, nëpërmjet ZKA-së, për hetime të mëtejshme pranë Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik/AFCOS.
- 2.7 Raportimi i parregullsive kryhet në përputhje me udhëzimet e OLAF-it “Udhëzime mbi një strukturë kombëtare për raportimin e parregullsive përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive (IMS)”.

Formati standard i regjistrit të parregullsive për fondet RGF, përcaktohet në shtojcën nr.11, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi

3. Raportimi i parregullsive të dyshuara për mashtrim nga auditimi i brendshëm.

- 3.1 Funkcioni i auditimit të brendshëm raporton menjëherë parregullsitë lidhur me fondet RGF gjatë një angazhimi auditimi, nëse audituesi i brendshëm krijon një dyshim të arsyeshëm për parregullsi të qëllimshme, lidhur me:
- a) Keqmenaxhimin e rëndë financiar.
 - b) Mashtrimin, vjedhjen, dëmtimin e pronës.

c) Keqpërdorimin e detyrës ose çdo shkelje ligjore që mund të përbëjë një vepër penale.

3.2 Audituesi i brendshëm është i detyruar të njoftojë me shkrim drejtuesin e njësisë së auditimit brenda 24 orëve. Informacioni i përgatitur nga audituesi i brendshëm duhet të përfshijë:

- a) Përshkrimin e fakteve dhe proceseve të dyshuara.
- b) Shumat financiare të përfshira (nëse dihen).
- c) Personat ose njësitë e përfshira.
- d) Dokumentacionin mbështetës.
- e) Vlerësimin paraprak të riskut për humbje të mëtejshme.

3.3 Drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të rishikojë informacionin e marrë brenda pesë ditëve dhe mund të kërkojë dokumentacion shtesë për të vlerësuar ekzistencën e parregullsisë.

3.4 Pas verifikimit të besueshmërisë së dyshimit, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm informon menjëherë dhe njëkohësisht:

- a) Titullarin e organit qendror të njësisë publike.
- b) Nëpunësin e Parë Autorizues në ministrinë përgjegjëse për financat, që mbikëqyr njësinë e inspektimit financiar publik.

3.5 Auditimi i brendshëm nuk kryen hetime administrative ose penale, por siguron dokumentimin profesional të fakteve.

3.6 Çdo punonjës, duke përfshirë audituesin e brendshëm, që raporton me mirëbesim dyshimet për parregullsi apo mashtrim nuk mund të ndëshkohet, diskriminohet, të ushtrohet presion, ose hakmarrje ndaj tij.

4. Politika e tolerancës zero ndaj mashrimit

4.1 Institucioni zbaton një politikë të tolerancës zero ndaj mashtrimit dhe çdo formë të parregullsisë të qëllimshme, që prekin fondet publike dhe fondet e BE.

4.2 Çdo rast i konfirmuar i mashtrimit ose shkeljeve të rënda rezultojnë në:

- a) Masa disiplinore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- b) Ndërprerje të marrëdhënieve kontraktuale, kur është e aplikueshme.
- c) Referim për ndjekje penale pranë autoriteteve kompetente.
- d) Rikuperim të plotë të dëmit financiar, përfshirë aplikimin e korigjimeve financiare dhe masave të tjera për mbrojtjen e interesave financiare të BE.

VIII. Konflikti i Interesit për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Konflikti i interesit

1.1 Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund

të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

1.2 Kjo është e vlefshme për:

- a) Zyrtarë publikë.
- b) Punonjës të administratës.
- c) Konsulentë.
- d) Ekspertë vlerësues.
- e) Çdo person të përfshirë në vendimmarrje, kontroll apo auditim.

1.3 Institucionet përfituese (ministritë, agjencitë zbatuese, autoritetet kontraktuese) duhet të zbatojnë:

- a) Deklarata të detyrueshme të konfliktit të interesit nga stafi përgjegjës për procesin.
- b) Deklarata të konfliktit të interesit, para përfshirjes në procedura vlerësimi, përzgjedhjeje, miratimi, auditimi, etj.
- c) Deklarata për interesa personale, familjare apo ekonomike.
- d) Sisteme të raportimit të veçantë për konfliktet e mundshme të interesit.

1.4 Personi në konflikt interesi nuk mund të marrë pjesë në:

- a) Vlerësim projektesh.
- b) Komisione tenderimi.
- c) Miratim pagesash.

1.5 Ndarje funksionesh, të detyrueshme për:

- a) Përzgjedhje.
- b) Zbatim.
- c) Kontroll.
- d) Auditim.

2. Trajtimi i konfliktit të interesit

2.1 Konflikti i interesit zbulohet nëpërmjet:

- a) Kontrolleve administrative dhe në terren.
- b) Sistemeve të raportimit dhe sinjalizimit.
- c) Auditimeve kombëtare dhe të BE.
- d) Hetimeve nga OLAF (Zyra Evropiane Kundër Mashtrimit).
- e) EPPO (Prokuroria Evropiane), kur ka vepra penale.

2.2 Në rast konflikt interesi, merren masat e mëposhtme:

- a) Masa korigjuuese.
- b) Përrjashtim i personit përgjegjës.
- c) Anulim i procedurës.
- d) Korigjime financiare.
- e) Kthim fondesh në buxhetin e BE.
- f) Sanksione.
- g) Masa disiplinore.

h) Kallëzim penal, nëse ka mashtrim ose korrupsion.

2.3 Në rast konflikti interesi, ndërmerren këto veprime:

- a)* Regjistër risku për konflikt interesi.
- b)* Rotacion i stafit.
- c)* Trajnime periodike.
- d)* Mekanizma denoncimi për sinjalizuesit.

3. Konflikti i interesit për audituesit e brendshëm rregullohet nga legjislacioni për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

IX. Etika dhe integriteti për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Kuadri rregullator

1.1 Kuadri rregullator për etikën dhe integritetin:

- a)* Kushtetuta.
- b)* Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.
- c)* Ligji nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar.
- d)* Ligji nr.9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- e)* Vendimi i Keshillit të Ministrave nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen gjatë veprimtarisë së nëpunësit të administratës publike”.
- f)* Kodet etike të institucioneve.
- g)* Standardet e BE për Instrumentin RGF.

2. Etika dhe integriteti

2.1 Zbatimi, menaxhimi, kontrolli dhe auditimi i fondeve të Instrumentit për Reforma dhe Rritje të Bashkimit Evropian (RGF) kryhet në përputhje me parimet e ligjshmërisë, integritetit, paanshmërisë, transparencës, përgjegjshmërisë dhe mbrojtjes së interesave financiare të Bashkimit Evropian.

2.2 Nëpunësit civilë, personat e ngarkuar me funksione publike, si dhe çdo subjekt i përfshirë në zbatimin e fondeve RGF janë të detyruar të respektojnë standardet etike dhe të sjelljes profesionale, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe kërkesave për integritet të Bashkimit Evropian, përfshirë parimet e tolerancës zero ndaj mashtrimit dhe korrupsionit.

2.3 Çdo person i përfshirë në proceset e fondeve RGF ka detyrimin të parandalojë, deklarojë dhe trajtojë konfliktin real, potencial ose të perceptuar të interesit, në përputhje me legjislacionin për parandalimin e konfliktit të interesit dhe procedurat e posaçme të miratuara për fondet RGF.

2.4 Institucionet përgjegjëse për fondet RGF miratojnë dhe zbatojnë kode etike dhe procedura të brendshme specifike për fondet RGF, duke përfshirë mekanizma për:

- a)* Parandalimin dhe raportimin e mashtrimit dhe korrupsionit.
- b)* Parandalimin e financimit të dyfishtë.
- c)* Mbrojtjen e sinjalizuesve.
- d)* Ndarjen e funksioneve dhe gjurmueshmërinë e vendimmarrjes.

- 2.4 Shkelja e rregullave etike, e parimeve të integritetit ose e detyrimeve për parandalimin e mashtrimit në kuadër të fondeve RGF përbën shkelje disiplinore, administrative ose penale, sipas rastit, dhe sjell masa përkatëse, përfshirë korrigjime financiare dhe rikuperim fondesh.
- 2.5 Zbatimi i pikës 2, të kreut IX, monitorohet përmes kontrolleve të brendshme, auditimit të brendshëm dhe Deklaratës së Sigurisë, si dhe i nënshtrohet verifikimeve nga autoritetet kombëtare dhe institucionet e Bashkimit Evropian.

X. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm.

1. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm siguron harmonizimin metodologjik, monitorimin e cilësisë dhe mbështetjen profesionale të funksionit të auditimit të brendshëm për fondet e Instrumentit RGF të Bashkimit Evropian, me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE, forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe sigurimin e një qasjeje të unifikuar dhe të standardizuar në auditimin e fondeve të Instrumentit RGF.
2. Institucionet zbatuese përgatisin përmbledhje të raporteve të auditimit, të cilat dorëzohen brenda afateve të përcaktuara, në strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në ministrinë përgjegjëse për financat. Kjo strukturë përgatit Përmbledhjen e Auditimit në nivel kombëtar me rezultatet e auditimit, si pjesë e raportimit periodik dhe në mbështetje të kërkesave për pagesa për periudhën përkatëse.
3. Struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm përgatit Përmbledhjen e Auditimeve në nivel kombëtar, nëpërmjet:
 - a) Analizës së përmbledhjeve të auditimeve në nivel institucional, si dhe raporteve të auditimit të brendshëm.
 - b) Vlerësimit të nivelit të mbulimit të risqeve kryesore për interesat financiare të BE.
 - c) Vlerësimit të efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.
 - d) Identifikimit të dobësive sistematike dhe çështjeve horizontale.
 - e) Sigurimit të koherencës ndërmjet Deklaratës së Sigurisë, Përmbledhjes së Auditimeve dhe raporteve të auditimit.
 - f) Mbështetjes teknike për institucionet në adresimin e rezervave ose kufizimeve në Deklaratën e Sigurisë.
4. Informacioni nga struktura përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm përdoret si bazë për:
 - a) Raportim periodik te Komisioni Evropian.
 - b) Kërkesa për pagesa nën Instrumentin RGF.
 - c) Verifikime dhe misione auditimi të BE.

XI. Ruajtja e dokumentacionit dhe gjurma e auditimit për Instrumentin për Reformë dhe Rritje

1. Të gjitha dokumentet që lidhen me fondet RGF ruhen në mënyrë të plotë, të sigurt dhe të gjurmueshme, për një periudhë jo më pak se 7 vjet, sipas parashikimeve në marrëveshjet me Bashkimin Evropian.


2. Dokumentacioni duhet të garantojë:
 - a) Transparencë.
 - b) Gjurmueshmëri të vendimmarrjes.
 - c) Verifikueshmëri nga autoritetet kombëtare dhe të BE.

XII. Dispozita të fundit

1. Të gjitha institucionet, strukturat, njësitë zbatuese dhe subjektet e përfshira në menaxhimin, zbatimin, monitorimin dhe kontrollin e fondeve në kuadër të Instrumentit RGF, janë të detyruara që brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi, të miratojnë dokumentacionin, procedurat dhe të përshtasin praktikat dhe metodologjinë e punës, sipas dispozitave që përcaktohen në këtë udhëzim.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen:
 - a) Kordinatori Kombëtar (NC).
 - b) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA).
 - c) Ministrinë e linjës dhe institucionet përfituese nga instrumenti RGF.
 - d) Njësitë zbatuese dhe autoritetet kontraktuese.
 - e) Njësitë e auditimit të brendshëm.
 - f) Drejtoria e Përgjithshme e Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik.
 - g) Drejtoria e Inspektimit Financiar Publik (AFCOS).
3. Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr.21, datë 14.7.2025 “Për kontrollin e brendshëm dhe verifikimin e masave për zbatimin e instrumentit të facilitetit për reforma dhe rritje”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në fletoren zyrtare.

MINISTRI
Petrit MALAJ



Formati standard i Deklaratës së Sigurisë (DoA), në nivel kombëtar

Koordinatori Kombëtar

Faciliteti për Reforma dhe Rritje (RGF)

1. Identifikimi i deklaruesit

Unë, i nënshkruari, (Emër Mbiemër), në cilësinë time si Koordinator Kombëtar për Facilitetin për Reforma dhe Rritje (RGF) të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Marrëveshjen e Facilitetit për Reforma dhe Rritje dhe kuadrin përkatës rregullator të Bashkimit Evropian, paraqes këtë Deklaratë Sigurie në mbështetje të kërkesës për disbursim të fondeve të Bashkimit Evropian.

2. Objekti i deklaratës

Kjo deklaratë mbulon zbatimin e asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për periudhën **2024–2027**, për periudhën raportuese:

- (periudha raportuese / kërkesa për disbursim nr. _____)

Deklarata përfshin arritjet dhe objektivat, funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar ndaj Komisionit Evropian.

3. Përgjegjësitë

Si Koordinator Kombëtar, unë jam përgjegjës për:

- Bashkërendimin dhe koordinimin e punës me ministrinë e linjës dhe institucionet e tjera publike, të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave;
- Bashkërendimin me strukturat dhe autoritetet për përgatitjen e raporteve të monitorimit mbi përmbushjen e hapave të reformave (cilësorë dhe sasiorë), të përcaktuara në Agjendën Kombëtare të Reformave.

Institucionet zbatuese mbajnë përgjegjësi për ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e operacioneve që zbatojnë si dhe ministria përgjegjëse për financat mban përgjegjësi për monitorimin e operacionalizimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, koordinimin e sistemit të parandalimit, zbulimit, raportimit dhe korrigjimit të parregullsive, mashtrimeve, korrupsionit apo çdo veprimtarie tjetër të paligjshme që cenon interesat financiarë të Bashkimit Evropian si dhe ndjekjen e shkeljeve të rregullave të vendosura në marrëveshjen e facilitetit dhe marrëveshjen e huas.

4. Baza për sigurimin

Kjo deklaratë bazohet në një vlerësim gjithëpërfshirës të informacionit në dispozicionin tim, duke përfshirë:

- deklaratat e sigurisë të institucioneve zbatuese;
- raportet e monitorimit dhe verifikimit;
- rezultatet e sistemeve kombëtare të menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK);
- pëmbledhjen e auditimeve SoA;
- kontrollet administrative dhe verifikimet e kryera;
- informacion nga mekanizmat kundër mashtrimit dhe parregullsive;
- burime të tjera të arsyeshme sigurie.

Vlerësimi është kryer mbi bazën e parimit të sigurisë së arsyeshme dhe një qasjeje të bazuar në risk.

5. Deklarata e Sigurisë DoA

Bazuar në sa më sipër, deklaroj se:

5.1 Përdorimi i fondeve dhe përputhshmëria

Fondet e Bashkimit Evropian janë përdorur për qëllimet e përcaktuara dhe në përputhje me Marrëveshjen e Instrumentit, Agjendën e Reformës dhe rregullat përkatëse të BE-së, dhe arritjet dhe objektivat e raportuara janë arritur në mënyrë të kënaqshme.

5.2 Besueshmëria e raportimit

Informacioni i paraqitur në mbështetje të kërkesës për disbursim:

- është i saktë, i plotë dhe i besueshëm;
- bazohet në sisteme funksionale raportimi;
- mbështetet nga një gjurmë auditimi e përshtatshme dhe e verifikueshme.

5.3 Funkcionimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm

Janë në vend dhe funksionojnë sisteme efektive të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut, të cilat ofrojnë siguri të arsyeshme mbi:

- ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e operacioneve;
- mbrojtjen e aktiveve dhe fondeve;
- parandalimin dhe zbulimin e gabimeve dhe parregullsive;
- respektimin e parimeve të menaxhimit të shëndoshë financiar.

5.4 Mbrojtja e interesave financiare të Bashkimit Evropian

Janë vendosur masa të përshtatshme për:

- parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e parregullsive;
- luftën kundër mashtrimit dhe korrupsionit;

- menaxhimin e konflikteve të interesit;
- raportimin dhe ndjekjen e rasteve të dyshuara.

5.5 Shmangia e financimit të dyfishtë

Ekzistojnë mekanizma kontrolli dhe koordinimi që sigurojnë se financimi në kuadër të Instrumentit nuk rezulton në financim të dyfishtë nga programe të tjera të Bashkimit Evropian apo donatorë të tjerë.

6. Kufizimet e sigurisë

Siguria e dhënë në këtë deklaratë bazohet në informacionin e disponueshëm në momentin e nënshkrimit dhe në funksionimin normal të sistemeve të kontrollit, të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të eliminojnë plotësisht riskun e gabimeve apo parregullsive.

7. Rezerva (nëse ka)

Nuk ka rezerva.

Ose

Deklarata jepet me rezervat e mëposhtme:

8. Konkluzioni

Në bazë të gjykimit tim profesional dhe evidencave të disponueshme, unë jap siguri të arsyeshme se sistemet e menaxhimit dhe kontrollit funksionojnë në mënyrë efektive dhe se fondet e Bashkimit Evropian janë përdorur në përputhje me rregullat, objektivat dhe kërkesat e Instrumentit për Reforma dhe Rritje.

Nënshkrimi:

Emër Mbiemër

Koordinatori Kombëtar

Formati standard i Deklaratës së Sigurisë (DoA), në nivel institucional

1. Titulli

- Titulli: *Deklarata e Sigurisë (DoA)*
- Instrumenti: Reform and Growth Facility (RGF)
- Periudha e raportimit _____
- Institucioni përgjegjës _____
- Data dhe vendi _____
- Personi nënshkruar (Autoritet përgjegjës)

2. Deklarata Formale e Sigurisë

Unë, në cilësinë time si (pozicioni), bazuar në përgjegjësitë e mia menaxheriale dhe mbi informacionin në dispozicion, deklaroj se, sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të vendosura për zbatimin e Reform and Growth Facility (RGF) kanë funksionuar në mënyrë efektive gjatë periudhës së raportimit dhe japin siguri të arsyeshme se:

- fondet janë përdorur vetëm për qëllimet e miratuara;
- arritjet dhe objektivat janë arritur në përputhje me Marrëveshjen e Financimit;
- shpenzimet dhe rezultatet janë në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe legjislacionin kombëtar;
- informacioni i raportuar është i plotë, i saktë dhe i besueshëm;
- janë respektuar parimet e menaxhimit të shëndoshë financiar.

3. Kuadri ligjor

Deklarata bazohet në:

- Rregulloren Financiare të BE-së (EU Financial Regulation).
- Rregulloren e Reform and Growth Facility.
- Marrëveshjen e Financimit RGF.
- Udhëzimet e Komisionit Evropian për raportimin dhe sigurinë.
- Legjislacionin kombëtar për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

4. Përbushja e kriterëve për raportet dhe evidencat:

- Masat janë zbatuar plotësisht
 - Masat janë zbatuar pjesërisht
 - Masat nuk janë zbatuar
- Dhe se:
- Janë paraqitur raportet individuale për çdo masë të zbatuar
 - Raportet përfshijnë të dhëna të plota, të sakta dhe të besueshme

- Evidencat justifikojnë përmbushjen cilësore dhe sasiore të hapave
- Të dhënat janë në përputhje me afatin _____

5. Kontrolli i brendshëm dhe përdorimi i fondeve:

- Deklaroj se sistemi i kontrollit të brendshëm funksionon dhe siguron:
 - parandalimin dhe zbulimin e mashtrimit;
 - menaxhimin e konfliktit të interesit;
 - parandalimin e korrupsionit;
 - identifikimin dhe raportimin e parregullsive;
 - gjurmën e plotë të auditimit;
 - konfirmimin se fondet janë përdorur sipas legjislacionit në fuqi.

6. Financimi dhe shmangia e financimit të dyfishtë:

- Deklaroj që financimi për realizimin e masave nuk është mbështetur nga programe të tjera të BE-së
- Konfirmoj që nuk ka financim të dyfishtë me burime të tjera apo donatorë të tjerë

7. Auditimi i brendshëm dhe gjurma e auditimit:

- Nuk janë identifikuar parregullsi nga auditimi i brendshëm për hapat e zbatuar
- Ekziston gjurmë e auditimit për secilin hap të raportuar

8. Burimet e siguridhënies

- Auditimi i brendshëm
- Auditimi i jashtëm (nëse kryhet)
- Auditime të tjera

9. Mbulimi i auditimit dhe kufizimet

- Përqindja e fondeve RGF të audituara _____ %
- Objektiva të përmbushura
- Kufizime (nëse ka)

10. Rezultatet kryesore të auditimit

- Gjetje materiale _____
- Dobësi sistematike _____
- Ndikimi në arritjen në objektive _____

11. Mashtrimi, konflikti i interesit dhe financimi i dyfishtë

- Deklarim i qartë:

- Janë vendosur dhe funksionojnë mekanizma efektivë për parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e mashtrimit, konfliktit të interesit, korrupsionit dhe financimit të dyfishtë, në përputhje me kërkesat e Bashkimit Europian.

12. Parregullsitë dhe ndikimi financiar

- Vlera totale e parregullsive: _____ €
- Financim i dyfishtë: _____ €
- Masa korrigjuese: _____

13. Masat korrigjuese dhe risku i mbetur

- Statusi i masave _____
- Risku i mbetur _____

14. Rezervat (nëse ka)

Bazuar në gjetjet e auditimit, deklarata e sigurisë jepet me rezervë në lidhje me (_____), për shkak të (_____).

Nëse nuk ka rezerva → deklarohet shprehimisht

15. Përfundimi dhe opinion final

Zgjedhje e qartë (vetëm një):

Siguri pa rezerva

- nuk janë identifikuar parregullsi materiale;
- sistemet e kontrollit të brendshëm funksionojnë në mënyrë efektive;
- raportimi financiar dhe i performancës është i besueshëm;
- nuk ka dobësi sistemike me ndikim të rëndësishëm.

Siguri me rezerva

- ekzistojnë parregullsi materiale, por të kufizuara në shtrirje;
- dobësitë në kontroll janë të izoluara dhe jo sistemike;
- ndikimi financiar ose operacional është i moderuar (zakonisht në intervalin 2%–5%);
- janë ndërmarrë ose planifikuar masa korrigjuese.

Pa siguri

- identifikohen parregullsi të rëndësishme ose të përhapura;
- ekzistojnë dobësi sistemike në kontrollin e brendshëm;
- raportimi nuk është i besueshëm;
- ndikimi financiar është i lartë ose ka risk serioz për interesat financiare të BE-së;
- evidencat mbështetëse janë të pamjaftueshme ose të pasigurta.

16. Informacion shtesë dhe transparenca:

Konfirmohet se:

- Është bashkëlidhur informacioni i detajuar për çdo institucion dhe masë të raportuar
- Janë përfshirë konfirmimet zyrtare për secilën masë
- Evidencat ruhen sipas kërkesave të auditimit të BE-së

Nënshkrimi dhe Data

Emri / Mbiemri

Pozicioni

Firma

Data

Formati standard i Përmbledhjes së Auditimeve (SoA), në nivel kombëtar

1. Informacion i Përgjithshëm

- Shteti Anëtar / Institucioni Përgjegjës _____
- Programi / Instrumenti (p.sh. RGF – Reform and Growth Facility) _____
- Periudha e raportimit _____
- Autoriteti i Auditimit / Njësia e Auditimit të Brendshëm _____
- Data e përgatitjes së SoA _____

2. Kuadri Ligjor dhe Standardet e Aplikuara

- Bazë ligjore kombëtare _____
- Rregullore të BE-së (p.sh. RRF Regulation, Financial Regulation) _____
- Standardet profesionale:
 - IPPF (IIA) Po Jo
 - ISSAI (INTOSAI) Po Jo
 - Udhëzime të Komisionit Evropian Po Jo
 - Manuali Auditimit të Brendshëm Po Jo

3. Qëllimi dhe Fusha e Auditimit

Qëllimi i përgjithshëm i auditimeve

- Fusha e mbulimit: _____
- Sistemet: _____
- Operacionet: _____
- Projektet / masat: _____
- Lloji i auditimeve:
 - Audit sistemesh _____
 - Audit përputhshmërie _____
 - Audit performance _____
 - Etj _____
- Niveli i mbulimit (% e fondeve / masave): _____

4. Metodologjia e Auditimit

- Qasja e bazuar në risk Po Jo
 - Metodatat e testimit:
 - Teste dokumentuese Po Jo
 - Teste në terren Po Jo
 - Provë/ Shembull Po Jo
 - Periudha e kryerjes së auditimeve
-

5. Përmbledhje e Auditimeve të Kryera

(Tabelë standarde)

Nr	Subjekti i Audituar	Lloji i auditimit	Periudha	Statusi
1	Ministria / Agjencia	Sistemi	xxxxx	Final
2	Programi xxx	Financiar	xxxxx	Final
3	Masat	Përputhshmërie	xxxxx	Në proces

6. Gjetjet Kryesore të Auditimit

- Dobësi në sistemet e kontrollit të brendshëm Po Jo
- _____
- Shkelje procedurale / ligjore Po Jo
- _____
- Mangësi në menaxhimin financiar Po Jo
- _____
- Dobësi në parandalimin e:
 - Mashtrimit Po Jo
 - Konfliktit të interesit Po Jo
 - Financimit të dyfishtë Po Jo

Nëse përgjigjia është PO, bëni sqarimet e nevojshme

7. Parregullsitë dhe Ndikimi Financiar

- Numri i parregullsive:

- _____
- Vlera financiare e prekur:

- _____
- Kategorizimi:

- Materiale / Jo materiale

- _____
- Sistemike / të izoluara

8. Masat Korigjuese dhe Statusi i Tyre

- Masat e rekomanduara Nr. _____ masave
- Afati i zbatimit dhe statusi i tyre për cdo masë:

Nr	Masat	Autoriteti përgjegjës	Afati	Stausi i zbatimit
1	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX	Xxxx	xxxx	I zbatuar
2	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX	Xxxx	xxxx	I pazbatuar
3	XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX	Xxxx	xxxx	Në proces

9. Vlerësimi i Besueshmërisë së Sistemeve

- Niveli i sigurisë:

- I lartë
- I moderuar
- I ulët

Vo: Shpjegim i detyrueshëm për nivel moderuar ose të ulët.

10. Opinioni i Përgjithshëm i Auditimit të Brendshëm

Bazuar në auditimet e kryera, Autoriteti i Auditimit vlerëson se sistemi i menaxhimit dhe kontrollit për fondet e BE-së funksionon në mënyrë:

- Efektive
- Pjesërisht efektive
- Jo efektive

Vo: përshkruani nëse sistemi është pjesërisht efektiv ose jo efektiv.

11. Lidhja me Deklaratën e Sigurisë (DoA)

- Kontributi i gjetjeve në DoA:

- Përputhshmëria me opinionin e deklaruar:

- Çështje që mund të ndikojnë opinionin:

